

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2020

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1 javë <3 muaj	REPO Njëditore
2-Pri-20		23.41		
06-Pri-20			4.62	
9-Pri-20		19.10		
16-Pri-20		19.04		
23-Pri-20		18.85		
24-Pri-20			4.44	
30-Pri-20		18.53		
7-Maj-20		14.54		
14-Maj-20		17.12		
21-Maj-20		20.93		
26-Maj-20			7.3	
28-Maj-20		17.58		
4-Qer-20		16.96		
11- Qer -20		13.76		
16- Qer -20			2.8	
18- Qer -20		18.19		
24- Qer -20			4.59	
25- Qer -20		19.31		
2-Korr-20		16.80		
9- Korr -20		12.94		
16- Korr -20		26.87		

Në tremujorin e dytë të vitit 2020, ndërhyrjet e BSh-së në tregun e parasë konsistuan në operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 33.63 miliardë lekë kundrejt 27.34 miliardëve lekë në 3-mujorin e mëparshëm dhe 26.88 miliardë lekë në 3-mujorin e dytë të vitit 2019.

Kërkesa e bankave për likuiditet në operacionet e Bankës së Shqipërisë ka qenë afër 32.00 miliardë lekë në fillim të periudhës dhe 34.00 miliardë lekë në fund të periudhës, duke u luhatur në intervalin 29-38 miliardë lekë dhe me tendencë

rritëse, kryesisht për shkak të tendencës së bankave për të rritur likuiditetin e tepërt dhe efektit të rritjes së parasë në qarkullim. Në vijim të prirjes së evidentuar prej muajit shkurt, paraja në qarkullim ka qenë faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e nevojës së bankave për likuiditet. Pasi është rritur në periudhën shkurt-mars me 9.02 miliardë lekë, në 3-mujorin e dytë të vitit, paraja në qarkullim është rritur me 22.20 miliardë lekë.


¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti

Faktor me ndikim pozitiv në likuiditetin e sistemit bankar dhe që ka zbutur presionin për kërkesë të lartë të bankave për likuiditet kanë qenë operacionet e tjera të Bankës së Shqipërisë si, rritja e marrëveshjeve SWAP me MFE për rreth 19.50 miliardë lekë, blerja nga EBRD e 49 milionë Euro me vlerë 6.125 miliardë lekë, si dhe rritja e portofolit të bonove të thesarit me 6.90 miliardë lekë.

Gjendja e likuiditetit në llogarinë e qeverisë ka pasur luhajtje jo të mëdha.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 18.28 miliardë lekë ose rreth 54.36% të injektimeve totale. Në përputhje me vendimin e KZKPM-së, prej javës së dytë të muajit mars, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar formën e ankandit nga “ankand me shumë të fiksuar” në “ankand me çmim uniform”.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2020 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë




1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese nga sistemi bankar

Sistemi bankar ka përdorur depozitën në BSh në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 6.73 miliardë lekë kundrejt mesatarisht 6.76 miliardë lekëve dhe 6.20 miliardë lekë në 3-mujorët e mëparshëm. Instrumenti i kredisë njëditore nuk është përdorur në asnjë rast kundrejt 1 dhe 3 raste në 3-mujorët paraardhës.

1.3 Operacionet për menaxhimin e portofolit të Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2020, portofoli i Bankës së Shqipërisë është rritur me 6.90 miliardë lekë pasi u rrit me 2.40 miliardë lekë në 3-mujorin e mëparshëm. Banka e Shqipërisë ka synuar rritjen e portofolit gjatë 3-mujorit për shkak të projeksioneve për rritje të nevojës së bankave për likuiditet në nivele të larta. Pjesëmarrja e bankave në ankande ka qenë në nivele rekord deri në mesin e muajit maj, ndërsa më pas interesi ka qenë në rënie.

Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, pas një periudhe 5-vjeçare me luhatje të ulëta, gjatë 6 muajve të parë të vitit 2020, rritja e portofolit të letrave me vlerë të qeverisë ka qenë 9.3 miliardë lekë, pranë niveleve të periudhës 2010-2014.



1.4 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë periudhës nuk janë kryer operacione të injektimit apo tërheqjes njëditore të likuiditetit.

2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2020

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2020 nuk janë zhvilluar ankande për blerjen e valutës, në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të dt. 31 mars 2020, sikurse publikuar më poshtë:

Kalendari i ndërhyrjeve në treg

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2020			
	Data	Shuma Raundi I (në euro)	Anulluar
1	21/02/2020	4-6 mln	
2	20/03/2020	4-6 mln	
3	15/04/2020	4-6 mln	**
4	07/05/2020	4-6 mln	**
5	21/05/2020	4-6 mln	**
6	05/06/2020	4-6 mln	**
7	19/06/2020	4-6 mln	**
8	03/07/2020	4-6 mln	**
9	17/07/2020	4-6 mln	**
10	03/08/2020	4-6 mln	**
11	21/08/2020	4-6 mln	**
12	25/09/2020	4-6 mln	**
13	22/10/2020	4-6 mln	**
14	06/11/2020	4-6 mln	**
15	20/11/2020	4-6 mln	**
16	04/12/2020	4-6 mln	**
17	18/12/2020	4-6 mln	**

* Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.

** Anulluar

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020

Në link-un e mëposhtëm gjeni informacionin mbi ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutë të përditësuar me ankandet e anuluar.

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

2.2 Veprime me institucione të tjera

Pas ndërprerjes në 3-mujorin e parë të vitit 2020, në 3-mujorit të dytë, MFE-ja ka përdorur sërish operacionet SWAP me Bankën e Shqipërisë, duke rritur gradualisht shumën e përdorur në fund të muajit qershor në rreth 24 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë ka blerë 49 milionë Euro nga EBRD gjatë 3-mujorit të dytë.

Blerjet e zakonshme të valutës nga institucionet e huaja kanë qenë 480,136.86 USD dhe 4,346,005.00 Euro nga IBRD, ndërkohë që janë blerë 1,656,604.70 Euro nga programi i Komunitetit Evropian IPA dhe i janë shitur ASD-së 3,842,600.00 Euro.